

Bibël për fëmijët
paraqet

Premtimi i
Perëndisë
Abrahamit



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus
Alastair Paterson

Adaptuar nga: M. Maillot; Tammy S.


Përkthyer nga: Arianit Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2020 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta
shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.





Shumë kohë
pas Përmbytjes,
njerëzit mbi tokë
bënë një plan.



“Ne do të ndërtojmë
një qytet të madh
me një kullë deri në
qiell,” thanë ata.



“Le të jetojmë së bashku gjithmonë”.
Çdokush fliste të njëjtën gjuhë.



Perëndia donte që njerëzit
të banonin nëpër të gjithë
tokën që Ai kishte bërë.
Kështu Ai bëri diçka
të veçantë.



Papritmas, grupe
njerëzish flisnin ndryshe.
Perëndia u dha atyre
gjuhë të reja.



Ata që flisnin të njëjtën gjuhë, u larguan së bashku. Mbase njerëzit filluan të frikësohen, nga të tjerët



që nuk i
kuptonin më.



Në këtë mënyrë Perëndia bëri që
njerëzit të mbushnin vende të
ndryshme.



Qyteti që ata lanë quhej Babel,
që do të thotë Ngatërrim.



Vite më vonë
në një vend të
quajtur Ur
i Kaldeasve,
Perëndia i foli
një burri
që quhej
Abram.



“Lër këtë vend”,
Perëndia
urdhëroi.
“Shko, në
vendin që
unë do të
tregoj”.



Abrami u bind. Perëndia e drejtoi atë në Kanan. Gruaja e tij Sarai dhe nipi i tij Loti shkuan me të.




Në Kanan, që të dy, Abrami
dhe Loti u bënë të pasur.
Ata kishin kope të
mëdha me bagëti.




Nuk kishte mjaft kullotë
për kaq shumë kafshë.



Barinjtë e Lotit u grindën
me barinjtë e Abramit.



"Le të mos ketë zënka",
Abrami tha. "Ne do të
ndahemi. Lot, ti zgjidh
i pari vendin që të pëlqen."



Loti zgjodhi një fushë
të madhe, të gjelbër që
gëlonte me qytete
dhe fshatra.




Dukej mirë. Por qytetet
ishin vende shumë të
mbrapshta.



Pasi Loti u largua,
Perëndia i foli
sërisht Abramit.



An illustration of an elderly man with a long white beard and hair, wearing a red robe with a white sash. He stands on a grey cliff edge, looking out over a landscape with green hills, a blue river, and grey mountains under a blue sky. His hands are raised in a gesture of blessing or promise. A wooden staff lies on the ground near his feet.

“Unë të jap gjithë
vendin e Kananit, ty dhe
fëmijëve të tu përjetë”.

Abrami dhe
Sarai nuk
kishin fëmijë.



Si mundesh Perëndia
ta mbante premtimin
e Tij të madh?





Tre persona erdhën nga Perëndia tek Abrami dhe Sarai. "Ti do të kesh një fëmijë shpejt", thanë ata.





Sarai qeshi. Ajo
nuk e besoi mesazhin e Perëndisë.
Ajo ishte nëntëdhjetë vjeçe.





Perëndia i tha Abramit,
se ai tani do të quhej Abraham dhe
Sarai do të quhej Sara.



Perëndia i tha
gjithashtu
Abrahamit, ...





... se Ai do të
shkatërronte
dy qytetet e
mbrapshta të
Sodomës dhe

Gomorrës.



Nipi i Abrahamit,
Loti jetonte në
Sodomë me
familjen e tij.




Loti i besoi
paralajmërimet
të Perëndisë
kur erdhi,
por burrat e
vajzave të tij
refuzuan të
largohej nga
Sodoma.



Sa tragjike.
Ata nuk i
besuan Fjalës
së Perëndisë.



Vetëm Loti dhe dy vajzat
e tij dolën të sigurtë.
Zjarr dhe sqfur ra mbi
qytetet e ligj.



Në mënyrë të trisht-
ueshme, gruaja e Lotit
nuk iu bind
urdhërit të ...



... Perëndisë dhe
shikoi prapa ndërsa
po vraponte.



Ajo u kthye në
një statujë
kripe.



Perëndia
e mbajti
premtimin
e Tij ndaj
Abrahamit
dhe Sarës.



Ata patën një
fëmijë në moshë
të shkuar,
pikërisht
ashtu si
Perëndia
kishte
thënë. Sa u
gëzuan ata
kur Isaku lindi!



Mbase
Abrahamit
iu kujtua edhe
premtimi i



Perëndisë, ...



... për ti
dhënë atij
dhe fëmijëve
të tij, vendin
e Kananit



përjetë.



Perëndia do
ta mbante edhe
atë premtim.
Perëndia
gjithmonë

i mban

premtimet
e Tij.



Premtimi i Perëndisë Abrahamit

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Zanafilla 11-21

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë
çdo ditë! Gjoni 3:16

